



**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**



Shoqëria e akademikëve shqiptarë
Gesellschaft albanischer Akademiker
Society of Albanian academics
DIJA e.V.

Nr.166prot. datë 21.11.2022

Nr.D722prot. datë 21.11.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

DHE

SHOQËRISË SË AKADEMIKËVE SHQIPTARË – DIJA e.V.

ME QËLLIM RRJETËZIMIN DHE NXITJEN E

BASHKËPUNIMIT ME DIASPORËN SHKENCORE



PREAMBUL

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Shoqëria e Akademikëve Shqiptarë – DIJA e.V (në vijim referuar individualisht si "Palë") në vlerësim të qëllimeve të përbashkëta për të nxitur bashkëpunimin me fokus rritjes së profesionistëve dhe nxitjen e kërkimit shkencor në Diasporë;

Agjencia Kombëtare e Diasporës, është person juridik publik në formën e Agjencisë Autonome, me seli në Tiranë, në zbatim të Ligjit nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” i ndryshuar,

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka për mision zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën dhe detyrë të bashkëpunojë dhe të koordinojë aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e statusit të diasporës shqiptare;

Shoqëria e Akademikëve Shqiptarë – DIJA e.V është shoqatë jofitimprurëse me qendër në Mynih, Gjermani, e regjistruar pranë gjykatës përkatëse në Mynih si person juridik. Shoqëria DIJA e.V bashkon studiues nga diaspora me qëllim krijimin e bashkëpunimeve dhe rritjes së akademike, transferin e dijes, promovimin e kërkimit shkencor, të artit dhe kulturës si dhe arsimimin e të rriturve dhe formimin profesional të tyre, duke përfshirë edhe ndihmën për studentët.

Duke shprehur vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimeve të kësaj marrëveshjeje, Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Shoqëria e Akademikëve Shqiptarë – DIJA e.V kanë rënë dakord si më poshtë:



Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje, është realizimi i bashkëpunimit, midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Shoqërisë së Akademikëve Shqiptarë – DIJA e.V me objekt nxitjen e rrjetëzimit të profesionistëve në diasporë, bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor, organizimin e simpoziumeve, konferencave shkencore dhe stimulimin e botimeve e punimeve shkencore.
2. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të interpretohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Parimet e përgjithshme të bashkëpunimit

1. Palët do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor të diasporës mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok, në përputhje me vendimet e organeve kompetente dhe do t'u përgjigjen kërkesave për bashkëpunim, në përputhje me procedurat që bien dakord për t'u ndjekur reciprokisht.
2. Palët, në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën, brenda mandateve të tyre përkatës dhe në varësi të burimeve në dispozicion, do të zhvillojnë konsultime për të gjitha çështjet me interes të përbashkët. Për këtë qëllim, Palët do të shqyrtojnë kuadrin e duhur për këto konsultime kur do që të jetë e nevojshme.
3. Palët bien dakord për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe realizimin e interesave të përbashkëta, sa i takon bashkëpunimit me Diasporën shkencore shqiptare në fushën e kërkim - zhvillimit, organizimin e takimeve dhe konferencave shkencore, botimin e punimeve dhe studimeve shkencore.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Palët, brenda mandateve të tyre përkatëse dhe në varësi të disponueshmërisë së burimeve, bien dakord të përkrahin rrjetëzimin e profesionistëve në diasporë dhe të nxisin bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor.
2. Palët angazhohen në hartimin e nismave të përbashkëta, të projekteve në fushën e kërkimit shkencor, organizimin e simpoziumeve, takimeve dhe konferencave shkencore.
3. Botimin dhe publikimin e punimeve dhe studimeve shkencore të pjesëtarëve të



diasporës, përfshirë edhe promovimin e tyre.

4. Palët angazhohen të zhvillojnë aktivitetet vjetor me fokus rrjetëzimin e profesionistëve dhe shkëmbimin e dijeve midis profesionistëve në diasporë dhe të vendit të origjinës.

Neni 4

Zbatimi i marrëveshjes

1. Palët do të marrin masat e duhura për të siguruar bashkëpunimin dhe ndërlidhjen efektive ndërmjet tyre.
2. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë dhe Kryetari i Shoqërisë së Akademikëve Shqiptarë DIJA e.V. do të konsultohen rregullisht me njëri-tjetrin, për çështjet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje.

Neni 5

Marrëveshje shtesë

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Shoqëria e Akademikëve Shqiptarë – DIJA e.V., mund të aplikojnë për lidhjen e marrëveshjeve të veçanta shtesë, bazuar në vullnetin e palëve.

Neni 6

Konfidencialiteti

1. Gjithë informacioni, duke përfshirë informacionin personal që përmbahet nga Palët në lidhje me këtë Marrëveshje, trajtohet si konfidencial. Asnjë informacion nuk do të komunikohet ndonjë palë të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të palës së interesuar.
2. Palët duhet të respektojnë Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në rast se ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të dhëna personale gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje.
3. Palët duhet të respektojnë dispozitat e Ligjit Nr.35, datë 31/3/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse. Palët duhet të respektojnë gjithashtu dispozitat ligjore që dalin nga ligji gjerman për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave (Bundesdatenschutzgesetzes (BDSG)), duke përfshirë edhe aplikimin e Rregullorës së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (Datenschutz-Grundverordnung (DSGVO) nga 25.05.2018).
4. Pala nuk do të përdorë logot e Palës tjetër dhe /ose të Donatorit për aktivitete të përbashkëta pa marrëveshje paraprake me Palën dhe / ose Donatorin përkatës.
5. Detyrimet e parashikuara në këtë nen mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të afatit të kësaj Marrëveshje.



Neni 7

Zgjidhja e konflikteve

1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që rrjedh nga/ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo rastet e shkeljes, ndërprerjes apo pavlefshmërisë së saj, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negocimit mes Palëve.
2. Në rast se mosmarrëveshja, kundërshtimi apo pretendimi nuk është zgjidhur me negociata brenda 3 (tre) muajsh nga marrja e njoftimit nga njëra palë për ekzistencën e një mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose pretendimi të tillë, secila palë mund të kërkojë që mosmarrëveshja ose kërkesa të zgjidhet pranë organeve kompetente gjyqësore.

Neni 8

Hyrja në fuqi, ndryshimet dhe kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshjeje hartohet në gjuhën shqipe, në 2 (dy) kopje origjinale për secilën palë.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet ose të rinovohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve. Ndryshimi i propozuar duhet të bëhet me shkrim nga njëra palë dhe do të hyjë në fuqi pas pranimit të saj me shkrim nga pala tjetër.
3. Secila nga palët mund ta përfundojë këtë Marrëveshje duke i dhënë njoftim me shkrim 6 (gjashtë) muaj përpara palës tjetër.
4. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi, pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve.
5. Kjo Marrëveshje ka një kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh nga data e hyrjes në fuqi dhe mund të rinovohet për të njëjtën periudhë në bazë të një marrëveshjeje të shkruar midis palëve.

**SHOQËRIA E AKADEMIKËVE
SHQIPTARË- DIJA e.V.
KRYETAR
ESHREF JANUZAJ**

**AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS
DREJTOR EKZEKUTIV
SONILA HYSI**